

 Artículos & Opinión: Reportajes

Arti i violines ne Shqiperi

Florian Vlashi

*Violinisti eshte ai fenomen njerezor teper i
veçante qe ka brenda tij ne nje permase te
habitshme gjysem-tiger, gjysem-poet.*

Yehudi Menuhin

Eshte thuar se e pamundur te gjesh nje vend si Shqiperia ku te jenë si "te ngrira" ne kohe te gjitha etapat qe ka kaluar Arti i violines, qe nga origjina e hershme dhe e mjegullt deri ne ditet tona me tere kompleksitetin e tij. Le ti hedhim nje veshtrim te shpejte ketij vendi te vogel ku, si ne muze, ndesh historine shumeshekullore te mbretit te instrumentave.

Ne Alpet e Veriut te Shqiperise eshte nje instrument mjaft i dashur per vendasit, Lahuta, nje lloj shume i afert me ravanastron indian. Ky i fundit njihet si paraardhesi me i hershem i instrumentave me hark -3000 vjet para Krishtit. Duhet te kete ardhur ne Europe nga Persia e Arabia ne kohën e Kryqezatave (Dominic Gill). Fjala shqipe Lahute vjen nga ajo arabe ud -dru. Lahutari luan dhe kendon rapsodi me tema mitologjike dhe lahuta perdoret siç perdornin greket e lashte Liren, per te mbeshtetur efektet e kenges dhe poezise. Njihet metamorfoza qe pesoi arti muzikor europian me futjen e harkut nga Azia. Pra, atje eshte, i paprekur dhe i gjalle ne Alpet e Shqiperise, sikur debora e perjetshme te kete ngrire dhe kohen.

Dhe sot e kesaj dite vazhdon mister i krijimit te violines, mister qe e ben me te bukur dhe e vesh me nje tyl te magjishem kete instrument-mrekulli te krijuar nga Zoti.

Nga shkrimet dhe pikturat e epokes mesojme se violina filloi te shfaqet rreth gjysmes se pare te sh. XVI ne Italia dhe arriti kulmin me mjeshtrit kremoneze ne sh. XVII-XVIII. Sipas studiuësve, liutajot cremoneze e veneciane e merrnin drurin per instrumentat e tyre nga malet e Ballkanit ku jane Alpet shqiptare. Po nga aty merrnin dhe rreshiren me te cilen krijuan vernikun e famshem, sekretin e perjetshem te Stradivarit. Nuk dihet se kur hyri violina e pare ne Shqiperi, por kontakti me kete instrument duhet te jete mjaft i hershem.

Ne Epitom musical te vitit 1556 nga Philibert Jambe de Fer shkruhet "Ne quajme viola ato qe zoterinjte, tregtaret e njerezit e tjere te Vertuz kalojne kohen... Tjetra quhet violine dhe perdoret neper kercime popullore". Keshtu

u pa violina dhe nga shqiptaret, duke u bere mjaft e preferuar thujse ne te gjitha grupet e muzikes popullore sidomos ne zonen e mesme e te veriut ku ishte ne rrolin kryesor. Keto grupe prej 4-5 instrumentash luanin ne te gjitha festat dhe sidomos ne dasma. Ashtu si ne pikturat e Mark Chagallit, violinisti ishte per njerezit nje figure gjysem mitike, qe merrte pjese ne te gjitha ngjarjet e festat, duke u bere keshtu nje lloj deshmitari i ekzistences njerezore. Kjo shprehet dhe ne Kabate (forme e muzikes popullore ne dy pjese kontrastuese) ku pjesa e pare eshte "ad libitum" sentimentale, dehese e nostalgjike gati "ne te qare", ndersa pjesa e dyte nje gezim i shfrenuar deri ne ekstaze - dy fytyrat e jetes.

Per sa i perket rolit te violines ne Dasma ka nje spjegim interesant te profesorit anglez Wilfrid Mellers. Ai spjeron se te luajturit ne violine eshte si te krijosh jeten. Harku, dextra, ana aktive e fuqise mashkullore stimulon anen femerore universale, te majten (dhe vete violina te kujton trupin e femres, shkruan Menuhini) duke i dhene jete te gjitha formave potenciale qe ajo ka brenda.

Le ti hedhim nje shikim te shpejte fjales qe perdorin popuj te ndryshem per te luajturit ne violine: play (luaj) anglisht, tocar (prek) spanjisht, suonare (tingelloj) italisht, a cânta (kendoj) rumanisht, luaj ne shqip etj. Por ne shqip kjo fjale ka hyre me vone si shprehje e qyteterimit dhe progresit te gjuhes, sepse fjala evjeter eshte "me i ra", i bie violines, nje perzierje e dhunes dhe pasionit, qe ne zhargonin e njerezve perdoret dhe per te shprehur aktin seksual. Pra kemi nje marrredhenie me instrumentinume me larg se te luajturit, te prekurit, te tingelluarit... Dhe tek festa pagane si Dasma ana shoqerore dhe ajo erotike jane bashke.

Violinistet shqiptare, ndryshe nga ato te eurespe veriore qe luajne vetem ne pozicionin e pare, dallohen per virtuoizem qe i afron ato me violinistet cigane e çifute. Ato dominojne tastieren deri ne ekstrem, ndersa dora a djathte krijon ritmet dhe levizja e saj provokon levizjen e kercimit te njerezve perreth.

Eshte e çuditshme dhe ja vlen te theksohet ekzistenca ne muziken shqiptare te ritmeve me meter te perzier me baze numrat magjike 5 dhe 7, ndersa ne muziken "e qyteteruar" ritme jane te organizuar ne grupe simetrike. Kjo i jep muzikes shqiptare nje nerv ritmik ekspresiv, marramendes dhe mjaft te komplikuar qe te kujton ritmet e çuditshme te Bartok apo O. Maessien. Realizimi i Kabave kerkon nje teknike te larte qe shpesh here i afrohet dhe "*Aires gitanos*" te Sarasates. Violinistet ishin te pashkolluar por te magjepsnin me lojen e tyre gje qe te sjell ne mend legjenden e vjeter universale te lidhjes se violinistit me djallin.

Nderkohe qe muzika popullore eshte statike, e pashkolluar dhe shprehje e konservatorizmit e identitetit kombetar, muzika klasike eshte gjithnje ne zhvillim, ka te nevojshem kualifikimin dhe eshte tregues i progresit e pjesemarrjes ne Europen e qyteteruar. Dhe ne Shqiperi ndodhi kjo ndarje; nen influencen e kontaktit me Italine, u be e modes qe familjet fisnike dhe borgjeze te blinin violina ne Venedik apo Tirol. Kur nga lagjet popullore

vinin notat e nje violine boheme, nga dritaret e aristokrateve degjoheshin notat e Bach-ut apo Debussy-s. Keshtu filloi shkolla e mirefillte violinistike shqiptare e cila pati dy periudha A - para 1945 me influencen e shkolles çeke, austriake dhe italiane dhe B - pas 1945 me shtimin e shkollave ruse dhe rumune.

(A) Ne fundin e sh. XIX dhe fillimin e sh. XX ne Europe dominonte shkolla e Sevcik dhe Flesch. Profesori çek O. Sevcik (1852-1934) rinovoi teresisht tekniken e violines duke e leruar nga rregullat e kufizuara te se kaluares. Pa te do te ishte e veshtire te mendohej muzika e R. Shtrauss, Ysayse apo Debussy. Ai pati rreth 5000 studente nga a gjithe bota. Njeri prej tyre, Ludovik Naraçi, studioi me te ne Austri dhe Prage. Me kthimin ne atdhe te ketij violinisti hyri dhe shkolla me e re europiane ne Shqiperi. Kesaj ju bashkangjit dhe ajo italiane me violinistet Lam Petrela e Sofokli Paparisto bashke me shume violiniste italiane e françiskane qe formonin ne ate kohe orkestrat e vendit. U hapen klasat e violines ne shkollen e re te muzikes ne Tirane (1933) me mbeshtetjken e Italise, ne Normalen e Ilbasanit (1909), ne Liceun Francez te Korçes (1917). Lidhjet me Italine, Francen e Austrine ishin shume te forta; mjafton te permedim vetem qytetin e Duresit qe ne vitet 30-31 kishte 43 studente qe shkolloheshin ne keto vende, ne mes tyre dhe muzikante.

(B) Pas Luftes se Dyte Boterore Shqiperia kaloi ne Kampin Socialist. U ndje menjehere dominimi i shkolles ruse dhe lindore ne pergjithesi. Eshte e vertete qe komunizmi, me organizimin e centralizuar, masivizimin dhe trysnine e teorise famekeqe te Realizmit Socialist beri shume deme ne Arte, por shkolla instrumentale u prek me pak nga ideologjia e diktatures dhe diti te perfitoje nga organizimi dhe lidhja me shkollat e kampit socilist (Ruse, Çeke, Rumune, Gjermane D.). U hapen Shkolla muzike thuajse ne gjithe vendin, dhjete Shkolla te Mesme te Muzikes 12 vjeçare (nivel Konservatori) dhe Instituti i Larte i Arteve sot Akademia ne Tirane (4 vjeçare). Pra, tere studimet per violine perfshijne nje periudh prej 16 vjetesh. Violinisti dhe kompozitori Pjeter Gaci studjoi ne Moske me Prof. Yankelevichvazh dues i Yampolskit e Auer; violinisti dhe dirigjenti Eno Koço studjon ne shkollen e Leningradit; Genc Bogdo dhe Robert Papavrami studjojne ne Prage. Ky i fundit me prof. Peskai i shkolles Yoachim e Hubay. Influence te madhe pati shkolla rumune ku studjuan Raimonda Stefi e Pirro Gjezi por sidomos ardhja ne Shqiperi e profesorit rumun te njohur Modest Iftinki i cili la nje gjurme te forte ne shkollen shqiptare. Ajo italiane vazhdoi te ndjehej me violinistin Ibrahim Madhi e çelistin Ymer Skenderi nxenes i Janigros.

Mendoj se ne kete kompleksitet shkollash ne periudhen e dyte luajten rrol kryesore disa figura: Robert Papavrami vendosi bazat e shkolles moderne te violines. Ai eksperimentoi qe ne "virgjinitetin muzikore" absolut (4 vjeç) pervetesimin e teknikes violinistike ne baze te refleksit e psikologjise se femijeve. Sot ai punon ne France dhe metoda e tij ne Shkollen P. Rode te Gradignan ka terhequr vemendjen e shume muzikanteve ne te gjithe boten si dhe admirimin e Menuhinit. I biri dhe nxenesi i tij Tedi, fitues i disa konkurseve nder to dhe Sarasate, pò ben sot

nje karriere te shkelqyer. Modest Iftinki, njohes rigoroz i teknikes dhe disiplines violinistike, formoi nje brez te tere instrumentistesh te perfeksionuar qe perhapen metoden e tij ne gjithe vendin. Ndersa violinisti Ibrahim Madhi e çelisti Ymer Skenderi, vazhdues te shkolles Italo-Franceze, veç formimit te nje klase instrumentale mjaft cilesore, vendosen bazat e muzikes se dhomes, duke e "veshur" instrumentistin me nje sensibilitet e muzikalitet njerezore. Kjo, duke ju bashkuar pergatitjes teknike absolute te Papavramit, kompletoi figuren ideale te violinistit. *"Vetem keshtu ennergjia vitale rrjedh lirshem duke komunikuar ne violine "zerin e brendshem" te interpretit"* (Accardo).

Sot ne shqiperi degjon tingujt befasues te violines se Schnittkes apo Xenakis, tingujt hyjnore te Bahut, marramendes te Kabave qe, duke u perziere me ato misterioze te Lahutes se Malsise, krijojne keshtu nje "kolalzh" te çuditshem ku here shfaqet tigri dhe here poeti.